



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.476/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Mejreme Memaj e Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit L. S., nga fshati B., komuna e M., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 185 par.1 nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, avokatit Nuhi Krasniqi, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë, P.nr.73/2020 datë 2 tetor 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 15 gusht 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit L. S. për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë, P.nr.73/2020 datë 2 tetor 2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë, me aktgjykimin P.nr.73/2020 datë 2 tetor 2023, të pandehurin L. S. e ka shpall fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor, parashikuar me nenin 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) €, të cilën është obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Në të kundërtën i njëjti do t'i zëvendësohet me burgim ashtu që në një ditë burgimi do t'i llogariten 20€ të gjobës. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore sipas ankesës së mbrojtësit të pandehurit, aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1538/2023 datë 25 prill 2024

Kundër aktgjykimeve të lartcekura kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Nuhi Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj kërkesën si të bazuar, aktgjykimet e kundërshtuara t'i ndryshojë ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo anulohet dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.II.nr.272/2024 datë 6.08.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 pika 2 nën-pika 2.4 e 2.5 pasi që në shqyrtimin e çështjes nuk janë ftuar dëshmitarët A1. e A2. S. të cilët në momentin kur pretendohet se është kryer vepra penale kanë qenë në vendin e ngjarjes, kurse nuk ftohen me arsyetimin se janë në botën e jashtme. Pastaj, nuk merret dëshmia e dëshmitarit kryesor I. S. edhe pse pretendohet se ai kinse është rrahur nga i dënuari në momentin kur ka ndërhy e dëmtuara t'i ndajë, duke vlerësuar se ai nuk është i aftë të dëshmoj pa prezantuar asnjë dokument apo shkresë lidhur me aftësinë apo paaftësinë e tij, kurse merren në pyetje të gjithë anëtarët e familjes se të dëmtuarës madje edhe ata që deklarojnë se nuk kanë qenë në vendin e ngjarjes dhe një pjesë e të cilëve japin dëshmi kundërtëne. Pastaj, pranohen prova të papranueshme për kinse lëndimin e të dëmtuarës e cila pretendon se është paraqitur në QKMF në M. me 1.01.2020, kurse raporti lëshohet gjashtë ditë më vonë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme nuk janë të bazuara. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet në kërkesa. Se pari vlen të theksohet se refuzimi i një propozimi konkret të palëve qofte për administrimin e një prove apo ndërmarrjen e ndonjë veprimi procedural nuk ka të bëjë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kurse nga shkresat e lëndës nuk rezultojnë se personat e lartcekur në kërkesë janë propozuar që të dëgjohen si dëshmitar. Pavarësisht kësaj, edhe nën supozimin se këta persona janë propozuar që të dëgjohen si dëshmitar, duke pasur parasysh faktin se nga shkresat e lëndës del se këta persona nuk janë dëshmitar të ngjarjes, dëgjimi i tyre nuk do të kishte ndikim në vërtetimin e ngjarjes. Ndërsa, pretendimet e mbrojtësit se aktgjykimi i kundërshtuar mbështetet në provë të papranueshme dhe se nuk është gjykuar plotësisht lënda e akuzës janë të pabazuara. Sepse, me dispozita ligjore – nenin 251 të KPP është përcaktuar se kur një provë konsiderohet e papranueshme dhe sipas kësaj dispozite provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme, kurse, siç del nga shkresat e lëndës provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje janë marrë konform dispozitave ligjore, ndërsa, sa këto prova janë thellësisht të mbështetshme respektivisht provojnë elementet e veprës penale, shkaktimin e dëmit apo ndonjë çështje me rëndësi është çështje që vlerësohet nga Gjykata. Nga fakti se gjykata ia ka falë besimin raportit të QKMF në M. nuk mund

të pretendohet se ajo është provë e papranueshme, kurse siç del nga shkresat e lëndës prokurori ka propozuar që të dëgjohet dëshmitari I. S. në shqyrtimin gjyqësor, por për shkak të pengesave në të folur, e duke pasur parasysh se dëshmitarja F. si dëshmitare okulare e ngjarjes ishte dëgjuar, ka heq dorë nga propozimi për dëgjimin e dëshmitarit Ismet, të cilin propozim nuk e ka kundërshtuar mbrojtësi, kurse gjykata e ka aprovuar propozimin, prandaj për këtë gjykatë nuk janë të qarta pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim.

Pastaj, shkelja nga neni 384 par.2 pika 2.4 të KPP të pretenduara nga mbrojtësi nuk janë të qarta, ngase kjo shkelje ekziston kur gjykata nuk vendos për njëri nga shumë vepra penale të kryera në bashkim. Në rastin konkret i dënuari është akuzuar për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor për të cilën edhe është shpall fajtor e gjykuar, kurse, kur gjykata nuk vendos për ndonjë fakt vendimtar që përbën veprën penale ka të bëjë me mos vërtetim të gjendjes faktike, e varësisht nga rrethanat e rastit edhe me shkelje të ligjit penal.

Në fakt kjo gjykatë e mbështet konkludimin e gjykatave përkitazi me përgjegjësinë penale te dënuarit dhe zbatimin e ligjit penal në këtë çështje juridiko penale, kurse, konform dispozitës së nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

PML.nr.381/2024, më 15 gusht 2024

Procesmbajtësja,
Minire Xhamabazi

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka